

Termet e Referencës

“Trajnim me fëmijët- Digital Space is Civic Space”

I. HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983. Si organizatë përfaqëson, përkrah dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuara përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

II. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin “Advancing Rights and Participation of Children with Disabilities in Kosovo”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Projekti përqendrohet në ndërtimin e kapaciteteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të monitoruar të drejtat e tyre dhe për të ndikuar në vendimmarrje në nivel lokal.

Grupi Avokues i Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara “Hëna” është grup jo formal i themeluar nga HANDIKOS që nga viti 2017, i cili që nga themelimi ka për mision të garantoj të drejtat e fëmijëve për fëmijët me aftësi të kufizuara. HËNA përfaqëson nevojat e fëmijëve në nivel lokal dhe qendror, për më tepër është aktivisht i përfshirë në të gjitha proceset e HANDIKOS.

III. OBJEKTIVA E DETYRËS

Në kuadër të këtij projekti, HANDIKOS organizon një trajnim me fëmijët e Grupit Hëna dhe fëmijë të grupeve të tjera si RoR (Respect Our Rights) AKF (Asambleja Komunale e Fëmijëve) dhe të tjerë, me synim që të fuqizojë fëmijët që të përdorin hapësirën digjitale si mjet për pjesëmarrje qytetare, avokim dhe ndikim.

Trajnimi synon që fëmijët pjesëmarrës:

- të kuptojnë konceptin e hapësirës digjitale si hapësirë qytetare dhe rolin e tyre në të;
- të mësojnë mënyra praktike për shprehjen e mendimeve dhe prioriteteve të tyre përmes platformave digjitale;
- të zhvillojnë aftësi për përdorim të sigurt, etik dhe të përgjegjshëm të mediave digjitale;
- të kuptojnë se si mjetet digjitale mund të përdoren për avokim, dialog dhe komunikim me vendimmarrësit;
- të forcojnë vetëbesimin për pjesëmarrje aktive dhe kuptimplote në proceset qytetare dhe monitoruese.

IV. KUALIFIKIMI

- Preferohet diplomë në arsimin digjital, teknologji, ose fusha të ngjashme;
- Përvojë e dëshmuar në punë me fëmijë, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Njohuri dhe aftësi praktike në përdorimin e mjeteve dhe platformave digjitale për edukim, pjesëmarrje ose avokim;
- Përvojë në dizajnimin dhe fasilitimin e trajnimeve interaktive dhe pjesëmarrëse për fëmijë;
- Aftësi të forta komunikuese dhe ndjeshmëri ndaj përfshirjes së fëmijëve dhe të drejtave të tyre.

V. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Eksperti/ja do të jetë përgjegjës për:

- Hartimin e konceptit dhe agjendës së trajnimit në bashkëpunim me ekipin e projektit;
- Përgatitjen e materialeve trajnuese të përshtatura për fëmijë me aftësi të kufizuara (gjuhë e thjeshtuar, mjete vizuale, ushtrime praktike);
- Zbatimin e trajnimit duke përdorur metoda pjesëmarrëse dhe miqësore për fëmijët;
- Lehtësimin e diskutimeve me fëmijët për identifikimin e nevojave dhe prioriteteve të tyre;
- Mbështetjen e fëmijëve për të përdorur hapësirën digjitale për avokim dhe komunikim me vendimmarrësit;
- Dorëzimin e një raporti të shkurtër narrativ mbi procesin e trajnimit dhe rezultatet kryesore.

VI. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS. Angazhimi do të bëhet gjatë muajit Mars 2026 në bazë ditore, ku do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

Detyra	Kohëzgjatja
Përgatitja e metodologjisë së trajnimit	2 ditë
Fasilitimi i trajnimit	1 ditë
Hartimi i raportit të trajnimit	1 ditë
TOTALI	4 ditë

VII. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa do të bëhet pas përfundimit të aktivitetit dhe dorëzimit të raportit final të aprovuar nga HANDIKOS.

HANDIKOS do të realizoj pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit financiar.

VIII. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Metodologjia e punës për këtë angazhim;
- Curriculum Vitae (CV);
- Propozimi financiar.

Aplikimet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: handikos@handi-kos.org
cc: nora.simitciu@handi-kos.org.

Ju lutem, shkruani në subjekt “Trajnim me fëmijët- Digital Space is Civic Space”.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimit është 26 shkurt 2026

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk jeni nën hetim.**
- Poashtu duhet të nënshkruaj **Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve** si dhe **Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual — PSHAS** dhe t'u përmbahen kushteve dhe kriterëve të tyre.